

PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

PËR

**PËR PËRCAKTMIN E RREGULLAVE, PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË  
OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË VENDIMMARRJES SË MBËSHTETUR PËR  
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 3, të nenit 7, të Ligjit Nr. 93/2014, "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e rregullave, procedurave kritereve të ofrimit ë shërbimeve të vendimmarjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuari, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Transportit dhe Energjistikës, Ministria e Kulturës dhe njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**EDI RAMA**

**KRYEMINISTRI**

# **RREGULLAT E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË VENDIMMARRJES SË MBËSHTETUR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

## **I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

1. Vendimmarrje e mbështetur në kuptimin e këtij projektvendimi është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.
2. Mbështetja për vendimmarje ofrohet si alternativë fuqizuese, me qëllim përforcimin e të drejtave dhe lirive të personit me aftësi të kufizuar dhe pjesëmarrjen efektive të personit në shoqëri.
3. Ofrimi i vendimmarjes së mbështetur bazohet në respektin e vlerave, besimeve, traditave dhe dëshirave të personave me aftësi të kufizuar.
4. Vendimmarrja e mbështetur për personat me aftësi të kufizuara, fizike, mendore, intelektuale ose dëmtime shqisore ofrohet përmes aksesit në mbështetjen e nevojshme kur ata nuk janë plotësisht në gjendje të kujdesen për veten e tyre ose çështjet e përditshme.
5. Vendimmarrja e mbështetur synon marrjen e vendimeve të informuara dhe komunikimin e vendimeve për të rriturit që nuk kanë nevojë për një kujdestar ose një vendimmarrës tjetër zëvendësues vetëm për rastet kur vendimmarrja eë mbështetur është në interesin e pak dhe ky i fundit përfiton nga ndihma në vendimmarrje.
6. PAK në moshë madhore kanë të drejtë:
  - a. të zgjedhin mënyrën si do të jetojnë sipas mundësive të tyre,
  - b. të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe gjithpërfshirësë në aktivitetet e jetesës së përditshme, sipas vendimmarjes për interesin më të lartë të tyre.
  - c. të marrin vendime me mbështetje në formën më efektive dhe më pak kufizuese e ndërhyrëse.
  - ç. të pranojnë ose refuzojnë mbështetjen, ndihmën ose mbrojtjen, përsa kohë janë të aftë të marrin vendime për ato çështje dhe kjo nuk dëmon ton tjerët.

7. Mbështetësi ndihmon në marrjen dhe komunikimin e vendimeve për PAK në moshë madhore. Ai në asnjë rast nuk zëvendëson si vendimmarrës vetë Personat me Aftësi të Kufizuar.
8. Personi nuk do të konsiderohet si paaftë për të marrë vendime bazuar vetëm mbi faktin se vendimet e tij mund të mos pranohen nga mbështetësi i tij.
9. Mungesa e aftësisë për të marrë një vendim në një fushë të caktuar nuk nënkupton mungesën e aftësisë për të marrë vendime në fusha të tjera;
10. Mbështetja që ofrohet synohet të jetë sa më shkurtër në kohë dhe në përputhje me kërkeshat e individit.
11. PAK i cili përfiton mbështetjen në vendimmarrje prezumohet se ka aftësi për të marrë vetë vendime.
12. Personi që përfiton ndihmën nuk prezumohet si i paaftë për të marrë vendime, nëse personit informacioni i nevojshëm për të marrë vendime nuk i jepet në formën e përshtatur për atë duke përfshirë gjuhën e thjeshtuar, komunikimi jo verbal, ndihmën e shenjave, me ndihmën e mjeteve të ndryshme.
13. Marrëveshja e vendimmarjes së mbështetur është alternative për vendimmarje të mbështetur për individët që janë në gjendje të marrin vendimet e tyre, por mund të kenë nevojë për ndihmë shtesë brenda fushave specifike.
14. Marrëveshja për vendimmarje të mbështetur nuk zëvendëson në asnjë rast alternativat ekzistuese si kujdestaria ligjore/ përfaqësuesi ligjor.
15. Kur është e mundur mbështetësit në vendimmarrje janë së paku dy persona të deklaruar si të tillë që bashkëpunojnë për procesin e mbështetjes.
16. Institucionet publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuar kanë detyrimin të marrin masat përkatëse për realizimin e vendimmarjes së mbështetur sipas kërkësës verbale/me shkrim.
17. Ministria përgjegjëse për çështjen e aftësisë së kufizuar, bashkitë dhe organizatat e/për afësinë e kufizuar bashkëpunojnë për nxitjen dhe ndërgjegjësimin e personave me aftësi të kufizuar për të përdorur vendimmarjen e mbështetur si një mjet për fuqizimin e autonomisë dhe pavarësisë së Personave me Aftësi të Kufizuar.

## **II. KRITERET E OFRIMIT TË VENDIMMARRJES SË MBËSHTETUR**

### **II.1. KRITERET PËR PËRFITIMIN E VENDIMMARRJES SË MBËSHTETUR PËR PAK JANË:**

1. Shërbimin e vendimmarrjes së mbështetur e përfitojnë personat me aftësi të kufizuar që kërkojnë këto shërbime dhe plotësojnë tre kriteret:
  - a. Person me aftësi të kufizuar që ka mbushur moshën 18 vjeç,
  - b. Person me aftësi të kufizuar që kërkojnë mbështetje, dëshirojnë dhe zgjedhin një shërbim të tillë.
  - c. Personi me aftësi të kufizuar PAK që kërkojnë mbështetje për vendime për çështjet e përditshme sipas marrëveshjes me vendimarrësin.
- ç. PAK që shfaqin vështirësi në kuptimin e informacionit apo faktet që i nevojiten për të marrë.

### **II. 2. KRITERET PËR MBËSHTETËSIN NË VENDIMMARRJEN E MBËSHTETUR**

1. Personi Mbështetës është i gatshëm që të mbështesë në vendimmarrje personin që kërkon këtë mbështetje, të veprojë në interesin e personit duke mbajtur në vëmendje dëshirat dhe preferencat e personit.
2. Mbështetësit për vendimmarrje janë individë ose grupe individësh që kanë plotësuar kriteret dhe janë zgjedhur prej personit me aftësi të kufizuar.
3. Mbështetësit janë individ/individë me zotësi të plotë për të vepruar, pa konflikt interesit me personin që i ofrojnë shërbimin e vendimarrjes së mbështetur.
4. Mbështetësit janë dënuar me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje dhe nuk kanë vendim gjykate me një nga masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje.
5. Mbështetësit janë:
  - a) shokë e/ose shoqe, anëtarë të familjes;
  - b) persona juridike që kryejnë funksione avokatie të personave me aftësi të kufizuar
  - c) persona të punësuar në qendra shërbimesh, qendra rezidenciale apo në komunitet;

- c) administratorë shoqërorë që kryejnë funksionet e koordinatorit të mbështetjes ose një punonjës nga strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkive dhe njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit.

### **III. PROCEDURA E VENDIMMARRJES SË MBËSHTETUR**

1. Shërbimet e mbështetjes në vendimmarjes përcaktohen nga nevojat e personit, zgjedhjet dhe dëshirat e tyre.
2. Personi me aftësi të kufizuara dhe mbështetësit e tij në vendimarrje nënshkruajnë një marrëveshje në të cilën përcaktohen fushat ku është e nevojshme ose ku kërcohët mbështetja, të cilën e dorëzojnë në njësinë administrative.
3. Gjatë përgatitjes së marrëveshjes ndiqet modeli i ofruar në Aneksin 1 të këtij vendimi dhe nënshkrimi kryhet me praninë e dy punonjësve nga shërbimi social i njësisë administrative.
4. Mbështetësi merr informacionin e duhur dhe bashkëpunon me punonjësin social në bashki, (shoqata etj) për të komunikuar ne mënyrë të kuptueshme dhe në formatin më të përshtatshëm për personin që merr vendimin;
5. Mbështetësit paraqiten individualisht/me Personat me Aftësi të Kufizuar në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, dhe kërkojnë me një shkresë ose në formë verbale që institucionet publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuar kanë detyrimin t'u japid informacionin e kërkuar mbështetësve të autorizuar për ta térhequr këtë informacion.
6. MSHMS dhe Shërbimi Social Shtetëror angazhohen që vendimarrjen e mbështetur ta përfshijnë në planin individual të punës të personit me aftësi të kufizuar nëse PAK është përfitues në qendrat e shërbimit ditor dhe rezidencial.
7. MSHMS dhe Shërbimi Social Shtetëror nxitin dhe promovojnë përgatitjen për vendimarrje të mbështetur nëpërmjet trajnimeve të posaçme dhe moduleve të trajnimit dhe formimit për

shërbimin e vendimmarjes së mbështetur dhe përgatit stafet e shërbimeve sociale pranë bashkive për të ofruar trajnimet e vendimmarrësve për vendimet që ndikojnë në përsitimin e shërbimeve sociale.

8. MSHMS bashkëpunon me strukturat e shërbimeve sociale në nivel rajonal dhe vendor për të përforcuar referimin e shërbimeve që ndihmojnë në vendimmarrjen e mbështetur.

#### **IV. DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Institucionet publike dhe jopublike të përcaktuara në këtë vendim kanë detyrimin që të shpjegojnë të drejtat dhe detyrimet personave me aftësi të kufizuara, pasojat e veprimeve me natyrë juridike duke përdorur teknika të përshtatshme për nivelin dhe llojin e aftësisë së kufizuar.

2. Ky vendim zbatohet për sa kohë nuk bie në kundërshtim me akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me heqjen e zotësisë për të vepruar, kujdestarisë ligjore dhe rregullave të përfaqësimit.

3. Në rast se parashikimet e përcaktuara në këtë vendim bien në kundërshtim me akte ligjore dhe nënligjore të tjera, do të zbatohet parimi i hierarkisë së normave.